

Në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83./18), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të dorëzuar nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Marshall Tito pn, Radovish, përmes Shoqërisë së Avokatëve Pepelugoski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më **12.04.2023**, solli

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Sveti spaso radovishki nr.1, Radovish do t'i bashkohet Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Marshall Tito pn, Radovish, **nuk bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 5.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) më 08.03.2023, i plotësuar më 21.03.2023, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) ka marrë njoftim për përqendrim nga Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Marshal Tito pn, Radovish, me të cilën Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Sveti spaso radovishki nr.1, Radovish do t'i bashkohet Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, me seli në rr. Marshall Tito pn, Radovish.

Në përputhje me nenin 12 të ligjit, përqendrimi ndodh me ndryshimin e kontrollit në bazë afatgjatë, dhe si rezultat i marrjes së kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të të gjitha ose pjesëve të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera nga një ose më shumë persona që tashmë kontrollojnë të paktën një ndërmarrje.

Në rastin konkret, nga të dhënat dhe dokumentet e paraqitura me njoftim dhe dokumentet e dorëzuara shtesë, Komisioni konstatoi se:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, është në pronësi të plotë të Solvaj Industries Esti OU me adresë, rr. Keskliina Linaosa, Narva MNT nr. 13, 10151 Talin Harju Maakond, Estoni.
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish është gjithashtu në pronësi të plotë të Solvaj Industries Esti OU me adresë rr. Keskliina Linaosa, Narva MNT nr. 13, 10151 Talin Harju Maakond, Estoni.

Nga njoftimi dhe nga ekstrakti i dorëzuar shihet për gjendjen aktuale të Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish dhe Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish.

Pra, në përputhje me Ligjin, Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish janë ndërmarrje të ndërlidhura dhe me bashkimin e Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol. SHPKNJP Radovish në Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish nuk ndodh ndryshimi i kontrollit në baza afatgjatë.

Gjithashtu, sipas pikës 6.1 (Ristrukturimi i brendshëm) i Udhëzimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konkurrencës për termin – përqendrim i datës 29.03.2012 “Sipas ligjit, përqendrimi ekziston kur ka ndryshime në kontroll. ***Ristrukturimi i brendshëm brenda një grupi ndërmarrjesh (të lidhura) nuk përbën një përqendrim. Kjo vlen p.sh.*** me rritjen e aksioneve/pjesëve ku nuk ka ndryshime në kontroll ose aktivitetet e ristrukturimit siç janë bashkimi i shoqërive me kuotim të dyfishtë në një person të vetëm juridik ose ***bashkimi i ndërmarrjeve të lidhura.*** Përqendrimi ndodh vetëm nëse transaksioni çon në një ndryshim në cilësinë e kontrollit në një ndërmarrje dhe si rrjedhim nuk është më një ndryshim thjesht i brendshëm.”

Për të gjitha të cekurat në rastin konkret, duke marrë parasysh të dhënat dhe dokumentet e dorëzuara me njoftimin dhe plotësimin, Komisioni konstatoi se me bashkimin e Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime Borov dol SHPKNJP Radovish në Shoqërinë për prodhim, tregtisë dhe shërbime Buçim SHPKNJP Radovish, *nuk ka ndryshim të kontrollit në baza afatgjata, prandaj përqendrimi në fjalë nuk bie nën dispozitat e Ligjit.*

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски